



Nr. 2358 Prot.



Nr. _____ Prot.

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
ndërmjet
UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS
dhe
ADAD Malore

Në Tiranë, sot më datë 23 / 09 / 2025, lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet palëve si më poshtë vijon:

“UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS” (UBT) i cili është një Universitet Publik me adresë Rruga "Pajsi Vodica", Kodër-Kamëz, Tiranë me përfaqësues ligjor **Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU**, në cilësinë e Rektorit.

dhe

“ADAD Malore” (Shoqata e Zhvillimit të Bujqësisë të Rretheve Malore) me adresë Rruga e Kavajës, Nd. 126, Sh.3, Ap. 46, KP 1023, Tiranë e përfaqësuar nga **Dr. Hafuz DOMI** në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv.

Universiteti Bujqësor i Tiranës është themeluar në vitin 1951 si Instituti i Lartë Bujqësor. Sot i njohur si UBT (Universiteti Bujqësor i Tiranës) është qendra e vetme e formimit universitar, kërkimit shkencor, trajnimit dhe zgjerimit në fushën e bujqësisë dhe ushqimit. UBT ka për mision edukimin profesional dhe kërkimin shkencor në fushën e bujqësisë, ushqimit dhe mjedisit.

ADAD Malore është organizatë profesionale bujqësore e themeluar në vitin 1996 dhe ka për objekt zhvillim bujqësor e rural, si dhe përforcimin e aktivitetit të prodhuesve. ADAD Malore vepron në të gjithë vendin e fokusuar kryesisht në rajonet e prodhimit të frutave. Ka partneritet me Agri Agency FERT Francë, AeV Itali, Esfim dhe programe si; GIZ/SRD, UNDP, USAID, etj.

ADAD Malore ka marrëveshje me MBZHR për organizimin e prodhuesve dhe kordinimin e aktorve dhe është iniciuese e koordinuese e dy instancave (kombëtare e lokale) në frutikulturë: KPF (Komiteti Përbashkët i Frutikulturës dhe FFK (Forumi Frutikulturë Korçë)

Këtu e më poshtë referuar individualisht si “**Pala**” ose si “**Palët**”.

Kjo marrëveshje është hartuar në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 15/2017 “*Për Arsimin dhe Formimin Profesional*”, Kodin e Punës dhe Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj *Marrëveshje* është të rregullojë dhe të institucionalizojë marrëdhënien e bashkëpunimit midis palëve për realizimin e projekteve mbi zhvillimin e arsimit të lartë, nëpërmjet rritjes së cilësisë së mësimdhënies në fushën e Frutikulturës nëpërmjet studimeve dhe projekteve të përbashkëta, zhvillimit të programeve të praktikave profesionale si dhe zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta me karakter profesional.

Neni 2

Fusha e bashkëpunimit

Për përmbushjen e qëllimit të kësaj *Marrëveshje*, fushat e bashkëpunimit dhe angazhimet përkatëse dy palët nënshkruese do të fokusohen në:

- 2.1 Shkëmbim informacioni për studime dhe inovacion në bujqësi.
- 2.2 Pjesëmarrje dhe organizim të aktiviteteve kombëtare për çështje të studimit, inovacionit apo të shpërndarjes së përvojave më të mira të vendit dhe të huaja
- 2.3 Realizimin dhe ndjekjen e studimeve dhe praktikave mësimore dhe profesionale pranë fermave të prodhuesve anëtarë të ADAD Malore
- 2.4 Mobilizimin e ekspertizës së UBT në aspekte të veçanta në shërbim të prodhuesve
- 2.5 Projekte të përbashkëta në sektorin bujqësor, koperimin dhe zhvillimin rural.
- 2.6 Angazhimi i studentëve në projekte dhe aktivitete të zbatuara nga ADAD Malore sipas mundësive dhe kërkesave.
- 2.7 Ofrimin e të dhënave të siguruara nëpërmjet rrjetit të instrumentacionit që administrohet nga ADAD Malore për qëllime kërkimore
- 2.8 Pjesëmarrje e ndërsjelltë në aktivitete të ndryshme të organizuara nga palët.
- 2.9 Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta.
- 2.10 Rekomandimi i studentëve potencialë tek sipërmarrës prodhues që janë anëtare ose bashkëpunëtorë të ADAD Malore.
- 2.11 Fushat e studimeve, praktikave dhe projekteve të përbashkëta do të shqyrohen nga palët sipas rëndësisë, disa nga temat e studimit jepen në [Aneks 1](#).

Neni 3

Dukshmëria në lidhje me kontributin e dhënë nga ADAD Malore

- 3.1 Universiteti merr përsipër dhe angazhohet të pasqyrojë foto dhe artikuj në faqen e tij zyrtare të internetit dhe/ose facebook në lidhje me kontributin e ofruar nga ADAD Malore për aktivitete ose projekte të ndryshme.
- 3.2 Në lidhje me projekte që kanë të bëjnë me infrastrukturën didaktike, Universiteti do të vendosë një pllakë dukshmërie të ndërhyrjes së bërë në një vend të dukshëm.

- 3.3 Në rast aktiviteteve të përbashkëta kontributi dhe logo zyrtare e ADAD Malore, duhet të përfshihen në të gjitha dokumentat e prodhuara për atë rast.
- 3.4 Në raste aktiviteteve ose projekteve të tjera të mbështetura nga ADAD Malore kontributi dhe logo zyrtare e ADAD Malore duhet të jenë të vendosura në vende të dukshme publikisht.
- 3.5 Sugjerohet që edhe në dokumentat të tjera të zhvilluara nga UBT për institucione të tjerë të përmendet edhe roli dhe kontributi përkatës i ADAD Malore.
- 3.6 Mirëpret dhe shikon mundësi realizimi të ideve të tjera që do të jepen nga ADAD Malore në lidhje me rritjen e dukshmërisë sociale.

Neni 5

Kohëzgjatja e marrëveshjes

- 5.1 Kjo marrëveshje bashkëpunimi do të lidhet me një afat 5 (pesë) vjeçar, dhe hyn në fuqi duke filluar nga data e nënshkrimit.
- 5.2 Pas përfundimit të afatit të përcaktuar sa më sipër, nëse nuk ka kundërshtime nga të dyja palët mund të rishikohet procesi i një tjetër marrëveshje bashkëpunimi.

Neni 6

Zgjidhja e Marrëveshjes

- 6.1 Palët kanë të drejtë të vendosin për përfundimin e kësaj marrëveshjeje edhe përpara afatit të përfundimit të përcaktuar në nenin 5, duke njoftuar me shkrim njëra tjetrën 30 ditë para.

Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis palëve

- 7.1 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje, apo të ndonjë marrëveshjeje tjetër, ose dokumenti të nënshkruar nga palët për zbatimin e saj, do të zgjidhet miqësisht nga palët, në të kundërt do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Neni 8

Njoftimet mes palëve

- 8.1 Çdo njoftim si dhe komunikim midis palëve lidhur me ndryshimet, shtesat apo me plotësimet që mund të lindin me kalimin e kohës për të realizuar këtë marrëveshje bashkëpunimi, do të kryhet në formë shkresore dhe do të konsiderohen si të dorëzuara rregullisht nëse dorëzohen dorazi, me postë të regjistruar, me postë elektronike ose me faks. Për kryerjen e kësaj procedure me efikasitet, palët caktojnë personat e kontaktit që janë përkatësisht:

Për Universitetin Bujqësor të Tiranës:

Person Kontakti: Prof. Dr. Endrit Kullaj, me detyrë Drejtor për Marrëdhëniet Institucionale

E-mail: ekullaj@ubt.edu.al

Celular: 00355 684096186

Për ADAD Malore:

Person Kontakti: Dr. Hafuz Domi, me detyrë Drejtor Ekzekutiv

E-mail: domihafuz@yahoo.com

Celular: 00355 68 20 66 485

8.2 Palët i komunikojnë njëra-tjetrës ndryshimet eventuale të përfaqësuesve.

Neni 9

Dispozita të Përgjithshme

- 9.1 Ndryshimet ose shtesat e pjesëshme që do t'i bëhen kësaj marrëveshje do të jenë të vlefshme vetëm nëse bëhen me miratimin dhe nënshkrimin e të dyja palëve.
- 9.2 Kjo marrëveshje është e hartuar në dy kopje në gjuhën shqipe, nga një kopje për secilën palë.

PALËT

UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS

Përfaqësuar nga:

Rektor

Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU



ADAD Malore

Përfaqësuar nga:

Drejtor Ekzekutiv

Dr. Hafuz DOMI



ANEKS 1

- Të ushqyerit sipas nevojave të pemës për specie dhe toka të ndryshme
- Ujitja sipas nevojave të pemës dhe përcaktimi i koeficientëve kultural sipas zonave klimatike
- Sjellja e kulturave ndaj ndryshimeve klimatike siç janë ngricat e vona të pranverës, breshëri, shfaqja e sëmundjeve dhe dëmtuesve të rinj, etj)
- Praktika të mira të kultivimit të pemëve frutore në përputhje me mjedisin
- Forma të reja të kultivimit, studimi dhe futja e varieteteve të reja në tregun vendas.
- Testime për rrallimin kimik të mollës
- Përcaktimi i kalendarit të vjeljes dhe i cilësisë së frutave sipas zonave klimatike (mollë, qershi, pjeshkë).
- Studimi i humbjeve në dhoma frigoriferike (humbje në peshë, dëmtimi nga sëmundjet, humbje ekonomike).